



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr.1126/3 Prot

ZYRA PERMBARIMORE "BASHA & I" SH P K
Tiranë. 09/09/2021

URDHËR

Për Heqjen e Sekuestro Konservative.

DREJTUAR : QKB

Në Tiranë, sot ne dt.09/09/2021

Unë përmbaruese gjyqësore Farije ISTREFI, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore me Nr.1126 regj, në zbatim të Urdhrin e Ekzekutimit nr.115/U, datë 05/05/2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë, leshuar për titullin ekzekutiv, vendimin nr.115, datë 05/05/2021 të Gjykatës Apelit Tirane

KONSTATOVA :

Se në dt.22/06/2021, është depozituar pranë Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Privat të Shoqërisë "**BASHA & I**" sh.p.k, është depozituar vendimin e transferimit nr.360-4 Regj, datë 22/06/2021 për ekzekutimin e titullin ekzekutiv vendimin nr.115 akt, datë 05/05/2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë, bashk me urdhërin e ekzekutimit nr.115/U, datë 05/05/2021, me palë :

- Kreditor : Shoqëria " Jundrit" shpk ne NUIS J92903320B
- Debitor : Shoqëria tregëtare "Banka e Tiranës" sha me NUIS J91924008V..
- Me objekt : Detyrim Kredije.

Nga studimi i materialeve në dosjen përmbarimore rezulton se : me vendimin nr.5419, datë 27/07/2021, është vendosur Anullimin e veprimit përmbarimor të Zyrës përmbarimore" Basha & I" shpk..... me nr.1126/2 prot, datë 22/06/2021 " Urdhër për vënien e sekuestros konservative".

URDHËROJMË

1. Heqjen e masës së sekuestros konservative mbi aksionet , **ne emer te debitorit** Tirana Bank me NUIS J61924008U, bazuar në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr.5419, datë 27/07/2021.
- 2.Për veprimet apo mosveprimet tuaja na vini në dijeni brenda afatit ligjor.
- 3.Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (paragII) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallëzim penal.
- 4.Ky urdhër mbahet në **4 kopje** dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit brenda **5** ditëve në Gjykatën e Rrethit.

PËRMBARUES GJYQËSOR
Farije ISTREFI

Adresa: Kotoni Center , Tiranë

Tel- Fax +355 2273377

mob. 0673019847



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR.13929 Regj.Them.
Date.12.07.2021

Nr.5419 Vendimi
Date.27.07.2021

VENDIM

“ NE EMER TE REPUBLIKES ”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTAR : Arben Kostandin

sot më datë 27.07.2021 mori në shqyrtim në dhome keshillimi çështjen civile që i përket palëve :

ANKUES : Shoqeria Tregtare “Banka e Tiranës” Sh.a, person juridik i regjistruar me QKB, qe vepron si Banke me Licencen Nr.07, date 12.09.1996 te leshuar nga Banka e Shqiperise, NUIS J61924008V me seli ne adresen: “Ibrahim Rugova” Nr.I, Tirane, perfaqesur nga Z. Dritan Mustafa, Drejtor Ekzekutiv, përfaqësuar me autorizim date 12.07.2021 nga Av.Erind Troka me Nr.8270 licence.

Shoqeria “Balfin-Balkan Finance Investment Group” shpk me NUIS K72223031K me adrese Njesia bashkiake nr.2, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndertesa Nr.12, Kati 11, Tirane me administrator Edlira Muka përfaqësuar me autorizim date 09.07.2021 nga Av.Erind Troka me Nr.8270 licence

KUNDER ; Zyres Permbarimore “BASHA & I” shpk, Permbarues Gjyqesor Privat Farije Istrefi (Basha) me adrese , Kotoni Center, Tirane, tel. +355 2273377, Cel 0673019847; dhe adrese ne Rruga Donika Kastrioti, Vila 9/1, Tirane.

PERSON I TRETE: Shoqeria " Jundrit" sh.p.k., me NUIS J62903320B me adrese: Kombinati Metalurgjik Elbasan .


OBJEKTI: 1. Kundershimin i Veprimeve Permbarimore te Zyres Permbarimore “BASHA & I” shpk, Permbarues Gjyqesor Privat Farije Istrefi (Basha) nr. 1126/2 prot, date 22.06.2021 “Urdher per venien e sekuestros konservative” duke urdheruar vendosjen e sekuestros konservative mbi aksionet e pales debitore ne emer te Debitorit Tirana Bank me NUIS J61924008U.
2.Pezullimin e ekzekutimit deri ne perfundim te ketij gjykimi..

BAZA LIGJORE: Nenet 610, 612 te K.Pr. Civile,

Gjykata pasi shqyrtoi provat ne dhome keshillimi

VEREN:

Se, ankuesit i jane drejtuar kesaj gjykate, me kunder Permbarues Gjyqesor privat . “Farije Istrefi (Basha) dhe person te trete Shoqëria " Jundrit" sh.p.k me objektin te ankimit ,si me siper Gjykata bazuar ne Nenet 36, 41, 50, 59, 610 te K. Pr. Civile, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykate eshte kompetente nga pikepamja e kompetences lendore e tokesore.



Gjykata duke iu referuar paragrafit te trete te nenit 610 te Kodit te Procedures Civile, te ndryshuar dhe te riformuluar vleresoi se ne kete rast nuk ka qene e nevojshme thirrja dhe degjimi i paleve ne séance pregatitore pregatitor dhe pertej dokumentacionit dhe ndergjyqesise se paraqitur vendimarjen e kreu ne dhome keshillimi .

Në bazë të nenit 35 të K. Pr. Civile gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

Nga shqyrtimi I provave rezultoi se ;

Ne daten 07.07.2021, Ankuesi "Banka Tirana" sha eshte vene ne dijeni te veprimit permbarimore te kryera Zyres Permbarimore "BASHA & I" shpk, Permbarues Gjyqesor Privat Farije Istrefi (Basha) "Urdher per venien e sekuestros konservative" nr. 1126/2 prot, Date 22.06.2021 duke urdheruar vendosjen e sekuestros konservative mbi aksionet e pales debitore, "Tirana Bank" sha me NUIS J61924008U ne lidhje me titullin ekzekutiv vendimi Nr. 115 date 05.05.2021i Gjykates se Apelit Tirane .

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranc me Vendimin nr.8127. date 04.10.2017, ka vendosur:

Rrezimin e kerkese padise.

Shpensmetgjyqesore ne ngarkim te paditesit.

Kunder ketij vendimi eshte ankimne Gjykatën e Apelit Tirane e cila me vendimi Nr. 115 date 05.05.2021 ka vendosur:

1.Ndryshimin e Vendimit nr. 8127, date 04.10.2017 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, si vijon :

a).Pranimin e pjesshem te padise,

b).Detyrimin e te paditurit "Banka Tirana" sha qe ti paguaje paditesit "Jundrit" sh.p.k shumen prej 180.078 euro.

c).Pushimin e gjykimit per kerkimet e tjera te padise,

ç) Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen pales se paditur "Banka e Tiranes" sh.a

d).Bashkelidhur leshohet edhe urdheri i ekzekutimit.

2.Kunder ketij vendimi mund te behet rekurs ne Gjykatën e Larte brenda 30 diteve duke filluar ky afat nga e nesermja e njoftimit te vendimit te arsyetuar.

Kunder ketij vendimi "Banka e Tiranes"ka ushtruar rekurs prane Gjykates se Larte

Ky rekurs eshte regjistruar prane Gjykates se Larte me date 25.05.2021 duke paraqitur edhe kerkese per pezullim te ekzekutimit te Vendimit Nr. 115 date 05.05.2021 te Gjykates se Apelit Tirane, kerkese e cila eshte mare ne shqyrtimi dhe Gjykata e Larte me date 14.07.2021 ka vendosur pezullimin e ekzekutimit te titullit ekzekutiv vendimi Nr. 115 date 05.05.2021i Gjykates se Apelit Tirane qe i eshte bere me dije edhe permbaruesit gjyqesor.

✚ Zyra Permbarimore "BASHA & I" shpk me Permbarues Gjyqesor Privat Farije Istrefi (Basha) pa pritur shqyrtimin e kerkeses per pezullim ne Gjykatën e Larte te pales ankues ka vazhduar procedurat e ekzekutimit me Urdhrin nr. 1126/2 prot. Date 22.06.2021 "Urdher per venien e sekuestros konservative" duke urdheruar vendosjen e sekuestros konservative mbi aksionet e pales debitore, ne emer te Debitorit Tirana Bank me NUIS J61924008U.

Sipas ankuesve ky urdher i Permbaruesit Gjyqesor Privat Farije Istrefi (Basha) eshte haptazi i paligjshem dhe i nxjerre ne kapercim te kompetencave te permbaruesit gjyqesor per keto arsye;

1.Urdhri nr. 1126/2 prot, Date 22.06.2021 i Permbarues Gjyqesor Privat Farije Istrefi (Basha) po ti referohemi permbytjes se aktit eshte nxjerr ne zbatim te neneve 527, 560 563 e vijues te K.Pr.Civile. Se pari:

Nenet 560, 563 jane pjese e Kreut III te Pjeses se IV te K.Pr.Civile i cili rregullon ekzekutimin mbi sendet e paluajtshme, mbi mjetet e lundrimit e të fluturimit ndersa neni 560 rregullon menyren e vendosjes se sekuestros ne Pasurite e Paluajtshme ndersa neni 563 rregullon verifikimin e te drejte se pronesise se debitorit per sendin e paluajtshem.

Sipas Urdhrit nr. 1126/2 prot, Date 22.06.2021 te Permbarues Gjyqesor Privat Farije Istrefi eshte urdheruar vendosjen e sekuestros konservative mbi aksionet e pales debitore, Tirana Bank me NUIS J61924008U, te cilat nuk jane sende te paluajtshme dhe ekzekutimi mbi to nuk rregullohet nga Kreut III i Pjeses se IV te Kodit te Procedures Civile.

Se dyti:

Ky veprim permbarimor objekt gjykimi eshte i kundraligjshem per shkak se cenon interesat pasuror te Shoqeria "Balfin - Balkan Finance Investment Group" shpk e cila nuk ka qene pale ne procesin gjyqesor dhe nuk eshte pale ne ekzekutim.

Shoqeria "Balfin - Balkan Finance Investment Group" shpk eshte zotruese e 100% te aksioneve te shoqerise "Banka e Tiranes" sh.a. vertetuar edhe nga ekstrati i shoqerise "Banka e Tiranes" sh.a. Neni 527 i KPrC parashikon se ;

Kur kerkohet ekzekutimi i nje detyrimi ne te holla, permharuesi gjyqesor, me kalimin e afatit te lajmerimit per ekzekutim (neni 517), fillon ekzekutimin e detyrueshem, duke vene sekuester mbi kreditet e debitorit dhe mbi sendet e luajtshme dhe te paluajtshme te dj. ne masen qe do tjetete e nevojshme per plotesimin e detyrimit.

Referuar permbarjes se nenit 527 te KPrC permbaruesi gjyqesor ka te drejte te vendos sekuester vetem mbi sendet e luajtshme qe jane ne pronesi te debitorit duke verifikuar nese sendet e luajtshme apo te paluajtshme jane ne pronesi te debitorit dhe pasi te sigurohet se keto sende jane ne pronesi te debitorit atehere mund te vendos sekuestro konservative mbi to.

Referuar titullit ekzekutiv vendimi Nr. 115 date 05.05.2021 te Gjykates se Apelit Tirane debitor i vetem eshte shoqeria Banka e Tiranes ndersa shoqeria "Balfin - Balkan Finance Investment Group" shpk jo vetem qe nuk ka patur asnje marredhenie tregtare me shoqerine "Jundrit" shpk por nuk ka qene pale ne kete proces gjyqesor dhe sipas Neni 451/a i KPrC Vendimi titull ekzekutiv ka fuqi vetem per cka eshte vendosur dhe i detyrueshem vetem per palet qe jane pjese e kesaj vendimarie .

Duke qene se aksionet e Bankes se Tiranes sh.a. zotrohen 100% nga Shoqeria "Balfin - Balkan Finance Investment Group" shpk dhe se kjo e fundit nuk ka qene pale ne procesin gjyqesor ne te cilin eshte nxjerre vendimi Nr. 115 date 05.05.2021 te Gjykates se Apelit Tirane si dhe nuk eshte pale ne ekzekutim atehere ne baze te Neni 612 i KPrC duhet te anulohet "Urdheri per venien e sekuestros konservative" nr. 1126/2 prot, date 22.06.2021 i Permbarues Gjyqesor Privat Farije Istrefi (Basha) si nje veprim i paligjshem dhe aksionet e Bankes se Tiranes duhet te perjashtohen nga sekuestrimi.

Se treti:

Duke qene se Banka e Tiranes sh.a. eshte institucion financiar Bankar, ezkecutimi mbi kete subjekt nuk mund te kryhet si me te gjitha subjektet e tjera pasi aktiviteti i ketij institucioni rregullohet me Ligjin nr. 9662. date 18.12.2006 "Per Bankat ne Republikën e Shqipërisë".

Referuar ketij ligji , asnje person nuk mund te jetë aksioner i drejtpërdrejtë ose i tërthortë në një bankë në qoftë se nuk ka reputacionin e duhur moral, sipas kriterëve të këtij ligji ose kërkesave të përcaktuara me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë, ose nuk gëzon pastërtinë penale në kohën e licencimit të bankës ose degës së bankës së huaj.

Transaksionet e aksioneve te institucioneve financiare Banka nuk jane nje veprimtari e lire ne treg por keto transaksione jane rregulluar me ligj te vecante per te garantuar stabilitetin financiar te ketyre institucioneve duke qene se per nga natyra keto institucione kane edhe karakter publik pasi ruajne dhe perdorin kursimet e publikut te gjere.

Permbaruesi gjyqesor ne asnje rast nuk mund t'ia nenshtronte procedurave te ankandit aksionet e nje institucioni financiar Bank pasi nje gje e till pengohet nga parashikimet e ligjit nr. 9662, date 18.12.2006 "Per Bankat ne Republikën e Shqipërisë".

Se katerti:

Se bashku me kete padi kemi kerkuar edhe pezullimin e veprimeve permbarimore deri ne zgjidhjen e kesaj ceshtje. Pezullimi i veprimeve permbarimore ne ceshtjen objekt gjykimi eshte i nje rendsie thelbesore pasi vazhdimi i ekzekutimit te detyrueshem mbi Aksionet e Bankes se Tiranes do te shkaktonte pasoja te pariparueshme per palen ankuese.

Nga ekstrakti i regjistrit tregtar, "statusi i subjektit", rezulton se shoqeria Jundrit shpk eshte ne gjendje pasive dhe nuk zhvillon aktivitet tregtar qe nga viti 2016.

Ne kushtet kur shoqeria Jundrit nuk zhvillon aktivitet tregtar, rezulton e qarte se situata e saj ekonomike nuk eshte e sigurt dhe nuk siguron ne te ardhmen mundesine e kthimit te shumave qe mund te ekzekutohen prane pales ankuese/debitore. Ne te kunderten pezullimi i veprimeve permbarimore nuk do te kete asnje pasoje per permbaruesin gjyqesor apo palen e trete. Shoqeria

Jundrit shpk ne cdo rast do te kete mundesine te ekzekutoje detyrimin ndaj pales ankuese, pasi kjo e fundit eshte nje shoqeri tregtare me kapacitet ekonomik shume te madh per shkak te natyres se aktivitetit qe zhvillon. Pikerisht per kete shkak, shoqeria "Jundrit" shpk ka sigurine absolute qe mund te ekzekutoje prane kesaj pale ne cdo moment ne te ardhmen.

Sa me siper ankuesit kerkuan pranimin e ankimit sipas objektit te saj.

Zyra Permbarimore "BASHA & I" shpk, me Permbarues Gjyqesor Privat Farije Istrefi (Basha) ne deklaraten e mbrojtjes parashtrori se ;

Me date 22/06/2021 kam filluar proceduren permbarimore ne lidhje me ekzekutimin e titullin ekzekutiv vendimin nr.115 akt, date 0505/2021 i Gjykatës së Apelit Tiranë, bashk me urdherin e ekzekutimit nr.115/U, date 05/05/2021, te Gjykates se Apelit Tirane Lajmërimi për ekzekutim vullnetar është marrë nga pala debitore 24/05/2021 dhe deri me 22/06/2021, nuk ka kryer asnjë veprim për të shlyer detyrimin.

Me marrjen e lajmërimit për ekzekutim vullnetar, debitori është i detyruar të deklarojë, me shkrim, gjendjen e tij pasurore, si dhe sendet ose kredi që persona të tretë i detytohen. nëse kjo kërkohet nga përmbasesi gjyqesor.

-Me shkresen nr 1126/1 prot date 22/06/2021 kam dërguar debitorit " Urdhërin për Sekuestro Konservative në Bankat e Nivelit të Dytë", e cila është marrë nga Banka e Tiranës më datë 23/06/2021

-Me shkresen nr 1126/2 prot date 22/06/2021 kam dërguar debitorit " Urdhërin për Sekuestro Konservative në QKB", e cila është marrë nga Banka e Tiranës më datë 08/07/2021.

-Sjell në vëmendjen e Gjykatës se sekuestroja në QKB, është dërguar pas marrjes së përgjigjes negative nga të gjitha bankat e nivelit të dytë.

-Debitor sipas vendimit të Gjykatës është shoqërisë tregëtare "Banka e Tiranës" sha me NUIS J61924008V, unë si përmbaruese gjyqësore nuk përcaktojë, as kreditorin, as debitorin .

-Shoqëria "Balfin-Balkan Finance Investment Group" shpk ka NIPT K2223031K dhe nuk ka asnjë sekuestro në këtë NIPT.

- Me shkresën 268 prot, datë 14/07/2021, jam njoftuar, me një fotokopje të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, se është marrë masa e pezullimit të ekzekutimit të vendimit nr.115, datë 05/05/2021.

Konkludojme se kërkesë padia është e pambështetur në ligj e prova për arsyet e mëposhtme:

Së pari - Bazuar ne nenin 515 të permbaruesja ka filluar ekzekutimin me kerkese te kreditorit, i cili paraqet urdherin e ekzekutimit origjinal dhe titullin ekzekutiv origjinal

Veprimet e permbaruesit jane mbeshtetur ne urdherin e ekzekutimit Vendimi nr. 115/U Regj themeltar date 05/05/2021 te Gjykates se Apelit Tirane dhe titullit ekzekutiv, vendimin nr.115, Date 05/05/2021 .

Së dyti - Titulli ekzekutiv, vendimin nr.115, Date 05/05/2021 është i formës së prerë dhe është saktësisht i përcaktuar debitori.

Së treti- Titulli ekzekutiv, vendimin nr.115, Date 05/05/2021, është i pezulluar nga Gjykata e Lartë.(vendimi akoma nuk është zbardhur).

Sa me siper kërkoi rezimin e ankimit ,

Personi I trete shoqëria " Jundrit" sh.p.k nuk paraqiti deklaraten e mbrojtjes megjithese aktet I jane njoftuar nga gjykata me deftesen e date 17.07.2021 dhe Brenda 5 diteve te caktuar nga gjykata nuk paraqiti deklaraten mbrojtje

Gjykata, nga ana e saj referuar objektit dhe bazes ligjore dhe provave te shqyrtuara ne dhome keshillimi çmon se referuar Nenit 6 të K. Pr. Civile percaktohet se:"Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet". Nga ana tjetër Neni 16/1 përcakton se "Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dipsozitat ligjore..... Gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës. Në Nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: "Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.". Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj, udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u

krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor. Cilësimi juridik i fakteve bëhet në përputhje me cilësimin ligjorë të tyre.

Duke iu referuar përmbajtjes së dispozitës së mësipërme ankimi i veçantë në kuptim të ligjit procedural (neni 443, paragrafi i katërt i Kodit të Procedurës Civile) nënkupton afatin 5 ditor nga e nesërmeja e marrjes dijeni. Gjykata vlerëson se afati i mësipërm është afat prekluziv, respektimi i të cilit përbën parakusht për marrjen në shqyrtim nga ana e Gjykatës e pretendimeve të ngritura në ankim. Provohet se ankuesi ka marrë dijeni për veprimet përmbartimore objekt i këtij gjykimi në datën 07.07.2021, ndërkohë që ankimi i paraqitur në Gjykatë është datë 12.07.2021 (shih vulat e gjyqesës pranë pullave të takses gjyqësore). Në këto kushte ankimi është kryer brenda afatit ligjor pasi afati fillon me datë 08.07.2021 dhe dita e fundi mbas 5 ditësh bie në datë 12.07.2021, çka mundëson Gjykatën në marrjen në shqyrtim të pretendimeve Ankuesit.

Gjykata vlerëson se në rastin në shqyrtim duke qenë se ankuesit Banka e Tiranës është debitori, sipas titullit ekzekutiv gëzon legjitimitet real aktiv dhe interes të ligjshëm, për të kundërshtuar veprimet përmbartimore që vlerëson se çënojnë interesat e tij të ligjshëm. Gjithashtu dhe Shoqëria "Balfin - Balkan Finance Investment Group" shpk është zotuese e 100% të aksioneve të shoqërisë "Banka e Tiranës" sh.a. vertetur edhe nga ekstrati i shoqërisë "Banka e Tiranës" sh.a dhe si e tillë edhe ajo gëzon legjitimitet aktiv në prekjen e aksioneve të saja.

Në lidhje me ligjshmërinë e veprimit proceduralë Urdhër nr. 1126/2 prot. Date 22.06.2021 "Urdhër për venien e sekuestros konservative" duke urdheruar vendosjen e sekuestros konservative mbi aksionet e pales debitore, "Tirana Bank" sh.a nga Zyra Përmbartimore "BASHA & I" shpk, me Përmbartues Gjyqësor Privat Farije Istrefi (Basha) gjykata cmon se është haptazi i paligjshëm dhe i nxjerre në kapercim të kompetencave të përmbartuesit gjyqësor pasi referuar bazës ligjore të perdorur nga përmbartuesja nënve 527, 560 563 e vijues të K.Pr.Civile. për vendosjen e sekuestros konservative mbi aksionet e pales debitore, aksione të cilat nuk janë sende të paluajtshme dhe ekzekutimi mbi to nuk rregullohet nga Kreut III i Pjesës së IV të K.Pr.Civile.

Ky veprim përmbartimor cenon interesat pasuror të Shoqëria "Balfin - Balkan Finance Investment Group" shpk e cila është zotuese e 100% të aksioneve të shoqërisë "Banka e Tiranës" sh.a. vertetur edhe nga ekstrati i shoqërisë "Banka e Tiranës" sh.a.


Referuar përmbajtjes së nenit 527 të KPrC përmbartuesi gjyqësor ka të drejtë të vendos sekuester vetëm mbi sendet e luajtshme që janë në pronësi të debitorit duke verifikuar nëse sendet e luajtshme apo të paluajtshme janë në pronësi të debitorit dhe pasi të sigurohet se këto sende janë në pronësi të debitorit atëherë mund të vendos sekuestro konservative mbi to.

Referuar titullit ekzekutiv vendimi Nr. 115 date 05.05.2021 të Gjyqesës së Apelit Tirane debitor I vetëm është shoqëria Banka e Tiranës ndërsa shoqëria "Balfin - Balkan Finance Investment Group" shpk është zotuese e 100% të aksioneve të shoqërisë "Banka e Tiranës" sh.a dhe nuk ka asnjë detyrim ndaj kreditorit shoqërisë "Jundrit" shpk., bazuar në Neni 612 i KPrC nuk mund të vendoset sekuestro mbi aksionet e saj dhe vendimi përmbartimor duhet të anulohet "Urdhëri për venien e sekuestros konservative" nr. 1126/2 prot, date 22.06.2021 i Përmbartues Gjyqësor Privat Farije Istrefi (Basha) si një veprim i paligjshëm.

Gjithashtu duke qenë se Banka e Tiranës sh.a. është institucion financiar Bankar, ekzekutimi mbi këte subjekt nuk mund të kryhet si me të gjithë subjektet e tjera pasi aktiviteti i këtij institucioni rregullohet me Ligjin nr. 9662. datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

Referuar këtij ligji, asnjë person nuk mund të jetë aksioner i drejtpërdrejtë ose i tërthortë në një bankë në qoftë se nuk ka reputacionin e duhur moral, sipas kriterëve të këtij ligji ose kërkesave të përcaktuara me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë, ose nuk gëzon pastërtinë penale në kohën e licencimit të bankës ose degës së bankës së huaj.

Transaksionet e aksioneve të institucioneve financiare Banka nuk janë një veprimtari e lire në treg por këto transaksione janë rregulluar me ligj të vecante për të garantuar stabilitetin financiar të këtyre institucioneve duke qenë se për nga natyra këto institucione kanë edhe karakter publik pasi ruajnë dhe perdorin kursimet e publikut të gjere.



Permbaruesi gjyqësor ne asnje rast nuk mund t'ia nenshtronte procedurave te ankandit aksionet e nje institucioni financiar Bank pasi nje gje e till pengohet nga parashikimet e ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

Sa me siper gjykata cmon se duhet vendosur pezullimi I ketij veprimi permbarimore deri sa vendimi te mare forme te prere . Pezullimi i veprimeve permbarimore ne ceshtjen objekt gjykimi eshte i nje rendesie thelbesore pasi vazhdimi i ekzekutimit te detyrueshem mbi Aksionet e Bankes se Tiranes do te shkaktonte pasoja te pariparueshme per palen ankuese.

Gjykata vlereson dhe faktin se Gjykata e larte ka pezulluar ekzekutimin e Titulli ekzekutiv, vendimin nr.115, Date 05/05/2021,(vendimi I cili akoma nuk është zbardhur) .

Sa me siper ankimi I ankuesve eshte I mbeshtetur ne prova e ne ligj e per pasoje duhet pranuar .

PER KETO ARSYE :

Gjykata bazuar ne Nenet 306, 610,te K. Pr. Civile.

VENDOSI :

- Pranimin e Ankimit te ankuesit "Banka e Tiranes "sha .
 - Anullimin e veprimit permbarimor te Zyres Permbarimore "BASHA&I" shpk me permbaruese gjyqësore private Farije Istrefi me Nr. 1126/2 Prot, datë 22.06.2021 "Urdher per venien e sekuestros conservative "duke urdheruar vendosjen e sekuestros conservative mbi aksionet e pales debitore ne emer te debitorit Tirana Bank me NIUS J61924008U sit e pabazuar ne ligj .
 - Pezullimin e ekzekutimit te ketij veprimi permbarimor deri kur te mare forme te prere vendimi.
 - Shpenzimet gjyqësore I ngarkohen Zyres Permbarimore "BASHA&I" shpk ..
- Kunder ketij vendimi lejohet te behet ankim i veçante ne Gjykatën e Apelit Tirane, brenda 5 diteve, afat ky qe fillon nga e nesermja e njoftimit te vendimit te arsyetuar paleve ndergjyqese.
- U shpall sot me date 27. 07.2021 ne Tirane.

GJYQATAR

ARBEN KOSTANDINI

Shpenzimet gjyqësore
Taksa padie 200 lekë
Njoftime 600 leke

